



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN sha

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Elbasan, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**Shtojca 13**

**[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Drejtuar: [BOE "VIANTE KONSTRUKSION" shpk dhe "LIS KONSTRUKSION" shpk]

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur – punë.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-14016-07-23-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [“Rikonstruksion i plotë i ujësjellësit të fshatrave Kotorr dhe Stror si dhe ndërtim i ujësjellësit të ri, Liras, Njësia Administrative Pishaj, Bashkia Gramsh”]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike 29.07.2024] [42]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

**oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “SENKA” shpk

J94808405Q

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 101 973 023,41 (njëqind e një milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëzet e tre presje dyzet e një) Lekë pa TVSH.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. BOE

“VIANTE KONSTRUKSION” shpk

K47103804L

“LIS KONSTRUKSION” shpk

K66613407H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 100 150 516,3 (njëqind milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë presje tre) Lekë pa TVSH.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. "SENKA" shpk	J94808405Q
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>Numri i NIPT-t</i>

*Për arsyet e mëposhtme:*

**"Operatori Ekonomik "SENKA" shpk, me NIPT J94808405Q nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë sipas kritereve të kërkuara nga AK:**

### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

#### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Ky kriter nuk është i plotësuar.**

### **Kapaciteti Teknik**

Është kërkuar pika 2.3.2 Licensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16. 01. 2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar. Licensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licensat e mëposhtme:**

N.S.-18 (Punime topogjeodezike,)	<b>Niveli C</b>
----------------------------------	-----------------

OE në licensën e paraqitur disponon

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licensat e mëposhtme:

N.S.-18 (Punime topogjeodezike,)	<b>Niveli B</b>
----------------------------------	-----------------

**Ky kriter nuk është i plotësuar.**

### **Është kërkuar pika 2.3.5:**

Operatori/ët ekonomik ofertues duhet disponojnë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

b) **1 (një)** person, pjesë e stafit të shoqërisë, të pajisur me certifikatën e Trajnimit për **“Përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë sipas ISO 9001:2015”**, (ose ekuivalente) e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

(Për përgjegjësin e kontrollit të cilësisë duhet të paraqitet Certifikata përkatëse si dhe Kontrata e punës e vlefshme si dhe të rezultojë në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit).

c) **1 (një)** person, pjesë e stafit të shoqërisë, të pajisur me certifikatë të Trajnimit për **“Punime në prani/prezence uji”**, e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

(Për përgjegjësin e Punimeve ne prani uji duhet të paraqitet Certifikata përkatëse si dhe Kontrata e punës e vlefshme si dhe të rezultojë në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit).

ç) **1 (një)** person, pjesë e stafit të shoqërisë, i certifikuar si **“Përgjegjës për mbrojtjen dhe administrimin/menaxhimin e dëmeve në mjedis”**, e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

OE nuk ka deklaruar se disponon stafin e mësipërm.

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij **4 (katër)** persona specialistë të certifikuar për **“Punime në lartësi”**, të cilët duhet të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë. Detyrimisht të paraqiten kontratat e punës dhe certifikatat përkatëse të tyre.

OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit te paraqitur disponon **2 (dy)** persona specialistë të certifikuar për **“Punime në lartësi”**,

**Ky kriter nuk është i plotësuar.**

#### **Është kërkuar pika 2.3.4:**

**Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet dhe kualifikimet e nevojshme për këto punime:**

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si Drejtues Teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- Minimumi 2 (dy) **Inxhinierë Hidroteknikë**

OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit te paraqitur disponon 1 **(një)** person **Inxhinier Hidroteknik në rolin e drejtuesit Teknik.**

**Ky kriter nuk është i plotësuar.**

#### **Është kërkuar pika 2.3.7:**

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si dhe të përfshirë në listë-pagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si më poshtë:

<b>Lloji i Specialistit</b>	<b>Numri i kërkuar</b>
-----------------------------	------------------------

Teknik Ndërtimi (me diplomë të mesme profesionale)	2
Gurë punues/Gurghendës	3
Murator / Suvatues	5
Karpentier	3
Hekurkthyes	3
Hidraulik	8
Saldator	3
Hidro-izolues	2
Pllakashtrues	1
Specialist duro/alumini	1
Betonues	3
Elektricitist	2
Bojaxhi	2
Mekanik	2
Specialist për konstruksione metalike/montator	2
Specialist ndërtimi	1

**OE ka mungesa në staf.** Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur disponon më pak punonjës

<b>Lloji i Specialistit</b>	<b>Numri i deklaruar nga OE</b>
Gurë punues/Gurghendës	-
Karpentier	2
Hekurkthyes	2
Hidraulik	2
Saldator	2
Specialist duro/alumini	-
Betonues	2
Mekanik	-
Specialist ndërtimi	-

**Ky kriter nuk është i plotësuar.**

**Është kërkuar pika 2.3.8:**

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi **6 (gjashtë)** shoferë të mjeteve të rënda/kamioni dhe **9 (nëntë)** manovratorë, të cilët duhet të figurojnë në listë-pagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën 3 muajt e fundit në rastin kur mjetet/makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qira, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Për stafin manovratorë/automakinist të paraqiten:
  - Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**OE ka mungesa në staf** në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur disponon me pak punonjës konkretisht 5 shoferë të mjeteve të rënda/kamioni dhe 6 manovratorë.

**Ky kriter nuk është i plotësuar.**

**Është kërkuar pika 2.3.9:**

Në përputhje me kërkesat dhe specifikat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe projekt preventiv, për materialet:

- a. Hekur ndërtimor;
- b. Rrjetë/tel i zinguar për rrethime, gabiona etj.;
- c. Hidraulike (tuba, rakorderi ujësjellësi);
- ç. Pompa zhytëse dhe njësi klorinimi;
- d. Puseta betoni/beton arme;
- dh. Bojëra për lyerje;
- e. Hidroizolues;
- ë. Elektrike.

Operatori/ët ekonomik duhet të paraqesin:

- Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave.
- Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.
- Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standardeve Evropiane si dhe të prodhuara nga prodhues të certifikuar / ose të pajisur me certifikatë konformiteti.

Për plotësimin e pikës 2.3.9, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk janë vetë prodhues apo furnizues të këtyre mallrave duhet ta dokumentojnë duke paraqitur Autorizimet/Kontratat përkatëse të furnizimit, si dhe certifikatat e sipër kërkuara për secilin prej mallrave si dhe një vetëdeklarim që është konform sistemeve të menaxhimit të cilësisë.

**Ky kriter nuk është i plotësuar. OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion.**

**Është kërkuar pika 2.3.10:**

Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës.

**OE ka mungesa në mjetet e mëposhtme:**

- Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 11 (njëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton për secilin kamion janë kërkuar 5 copë OE ka deklaruar se disponon 4 copë.
- Kamion (kapaciteti mbajtës minimumi 5 (pesë) ton dhe maksimumi 10 (dhjetë) ton për secilin kamion janë kërkuar 3 copë OE ka deklaruar se disponon 2 copë.
- Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pikë pesë) ton dhe maksimumi 5 (pesë) ton për secilin kamion janë kërkuar 2 copë OE nuk ka deklaruar se disponon këtë mjet.
- Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5 (një pikë pesë) ton dhe maksimumi 3.5 (tre pikë pesë) ton për secilën kamionçinë janë kërkuar 3 copë OE ka deklaruar se disponon 1 copë.
- Kamion (kapaciteti mbajtës mbi 20 (njëzet) ton janë kërkuar 3 copë OE ka deklaruar se disponon 2 copë.
- Fadromë me goma (Mjet teknologjik) janë kërkuar 4 copë ka deklaruar se disponon 1 copë.
- Makineri teknologjike (trancher) për frezim dhe hapje kanali me thellësi mbi 50 cm në rrugë të asfaltuara është kërkuar 1 copë nuk ka deklaruar se disponon këtë mjet.
- Autovinç janë kërkuar 2 copë OE ka deklaruar se disponon 1 copë.
- RTV Rimorkiator ose Karruatrec janë kërkuar 2 copë OE ka deklaruar se disponon 1 copë.
- Total Station për rilevime matje/azhornime topografike është kërkuar 1 copë nuk ka deklaruar se disponon këtë mjet.
- Sondë shpimi "UKS" ose ekuivalente  $\varnothing$  1 m, me thellësi shpimi mbi 35 m/l është kërkuar 1 copë nuk ka deklaruar se disponon këtë mjet.
- Sistem Well Point (ose ekuivalent) është kërkuar 1 copë nuk ka deklaruar se disponon këtë mjet.
- Aparaturë për bashkim/ngjitje tubacionesh me metodën "Elektro Fusion" janë kërkuar 2 copë nuk ka deklaruar se disponon këtë mjet.
- Aparaturë për bashkim/ngjitje tubacionesh me metodën "Kokë më kokë" janë kërkuar 2 copë nuk ka deklaruar se disponon këtë mjet.
- Pajisje e lëvizshme me ultratinguj për matjen e rrjedhjes / prurjes (Pajisja dixhitale) /ekuivalent Flowmeter është kërkuar 1 copë nuk ka deklaruar se disponon këtë mjet.

**Ky kriter nuk është i plotësuar. OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion.**

**Është kërkuar pika 2.3.11:**

Operatori/ët ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- Certifikatat e cilësisë sipas Standardit **ISO 1452-1:2009** (për sistemin e tubacioneve plastike për furnizim me ujë, kullimet dhe kanalizimet nëntokësore dhe mbitokësore) (ose ekuivalente), e vlefshme.

**Ky kriter nuk është i plotësuar. OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion.**

**Është kërkuar pika 2.3.12:**

b) Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga QKB me Kodin III.7.B “Shpues profesionist për ujë” - Veprimtaritë e Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë.

**Ky kriter nuk është i plotësuar. OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion.**

**Është kërkuar pika 2.3.14:**

Operatori/ët ekonomikë duhet të kenë kontratë noteriale më një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standardeve SSH EN SSH EN 12350-2:2019, SSH EN 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019 (ose ekuivalente).

**Ky kriter nuk është i plotësuar. OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion.**

Sa më sipër, **Operatori Ekonomik “SENKA” shpk, me NIPT J94808405Q, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë sipas kriterëve të kërkuara nga AK s’kualifikohet.”**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: *“VIANTE KONSTRUKSION” shpk, me adresë: Lagjja “SPORTI” Gramsh, përfaqësues i BOE “VIANTE KONSTRUKSION” shpk dhe “LIS KONSTRUKSION” shpk në bazë të Autorizim (përfaqësimi) mes palëve, të datës 16. 08. 2024, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **100 150 516,3** (njëqind milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë presje tre) Lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.*

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sha, me adresë: Lagjja “Brigada XVII Sulmuese”, Rruga: “Petraq Popa” Elbasan*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një

vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT /ENTIT KONTRAKTOR**  
**ADMINISTRATORI**  
**LUAN TABAKU**